



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE**  
**KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

20.05.2023

*“Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar”*

**ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)**

1. Raporti i ecurisë së veprimtarisë duhet të tregojë:

- a) Nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse, në mënyrë të drejtë zhvillimin dhe performancën e njësisë ekonomike, shoqëruar me një përshkrim të risqeve dhe pasigurive kryesore;
- b) Zhvillimet e mundshme, të ardhshme, të njësisë ekonomike;
- c) Informacionet që kanë të bëjnë me marrjen e aksioneve të veta;
- d) Ekzistencën e degëve të njësisë ekonomike;
- e) Politikat dhe objektivat e menaxhimit të riskut financiar;
- f) Ekspozimin e njësisë ekonomike ndaj riskut të çmimit, riskut të kreditit, riskut të likuiditetit dhe riskut të flukseve monetare;
- g) Vetëm a) dhe b)
- h) Të gjitha të mësipërmet

**Përgjigja e saktë është alternativa H**

2. Sipas SNK 38 “ Aktivet jo-materiale”, përkufizimi i një aktivi jo-material kërkon që aktivi jo-material të jetë i identifikueshëm për ta dalluar atë nga emri i mirë. Cilat prej kushteve me poshtë duhet të plotesojë një aktiv për t’u konsideruar i identifikueshëm?

- 1- Eshtë i ndashëm, d.m.th. ka mundësi të ndahet apo të veçohet nga njësia ekonomike
- 2- Ka mundësi të shitet, transferohet, licencohet, jepet me qira dhe këmbehet,
- 3- Veprimet e përmendura në dy alternativat me lart mund të kryhen qoftë individualisht apo së bashku me një kontratë, aktiv ose detyrim të lidhur, megjithëse njësia ekonomike vendos kështu.
- 4- Vjen nga të drejtat kontraktuale apo të drejta të tjera ligjore, pavarësisht nëse këto të drejta janë të transferueshme apo të ndashme nga njësia ekonomike ose nga të drejta apo detyrime të tjera;
- 5- Të gjitha me lart
- 6- Vetëm 1 dhe 2
- 7- Vetëm 2 dhe 4
- 8- Asnjë nga me lart

**Përgjigja e saktë është alternativa 5**

3. Cila nga alternativat e mëposhtme është shembull i situatave të kompensimit të të ardhurave me shpenzimet ku rezultati njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën neto:
- a) të ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale minus vlerën kontabël neto të aktivitetit
  - b) shpenzimet e qirasë të qiramarrësit dhe të ardhurat nga qiraja që gjenerohen nga dhënia e mëtejshme me qira e të njëjtit aktiv (duke supozuar që qiraja është aktivitet parësor i njësisë ekonomike)
  - c) të ardhurat dhe shpenzimet që të marra veças nuk janë materiale
  - d) fitimet/humbjet nga zbatimi i metodës së kapitalit
  - e) fitimet/humbjet nga shitja dhe rivlerësimi i investimeve financiare
  - f) të gjitha të mësipërmet
  - g) a, b, c, e
  - h) a, c, d, e

Përgjigja e saktë është alternativa H

4. Me çfarë vlere paraqiten në datën e pasqyrave financiare aktivet e mbajtura për shitje dhe në çfarë seksioni të pasqyrës paraqiten ato?
- a) Aktive afatgjata, me çmimin e shitjes në datën e pasqyrave financiare;
  - b) Aktive afatshkurtra, me koston e sigurimit;
  - c) Aktive afatgjata, me çmimin e tregut në datën e pasqyrave financiare;
  - d) Aktive afatshkurtra, me vlerën neto të realizueshme;
  - e) Aktive afatgjata, me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme;
  - f) Varet nga politikën, që ndjek njësi ekonomike;
  - g) Aktive afatgjata ose Aktive afatshkurtra, standarti përkatës të lejon mundësi zgjedhjeje;
  - h) Aktive afatshkurtra, me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme;

Përgjigja e saktë është alternativa H

5. Cili nga raportet e mëposhtme përdoret për të analizuar likuiditetin?
- a) Fitimet për aksion;
  - b) Raporti i borxhit ndaj kapitalit;
  - c) Raporti qarkullues;
  - d) Raporti i kthyshmërisë së aktiveve totale;
  - e) Raporti i kthyshmërisë së llogarive të arketueshme;
  - f) Raporti i kthyshmërisë së inventarit;
  - g) Cilësia e të ardhurave;
  - h) Marzhi i fitimit neto.

Përgjigja e saktë është alternativa C

6. Një njësi ekonomike duhet të njohë një grant i cili imponon kushte specifike në lidhje me performancën në të ardhmen në atë njësi ekonomike:
- a) në të ardhurat gjatë periudhave të nevojshme për t'u krahasuar me kostot përkatëse që granti ka për qëllim të kompensojë, në mënyrë sistematike
  - b) në të ardhurat, vetëm nëse janë përmbushur kërkesat në lidhje me performancën
  - c) në të ardhurat, kur të ardhurat nga granti priten të arkëtohen
  - d) drejtpërsëdrejti në kapital
  - e) në detyrimet
  - f) (a) dhe (e)
  - g) (b) dhe (c)
  - h) Asnjëra

Përgjigja e saktë është alternativa B

7. Sipas SKK 12 Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit cili nga zërat më poshtë klasifikohet si zë jo-monetar:
- a) detyrimi i qirasë
  - b) parapagime të dhëna për shërbime
  - c) provizione për çështje gjyqësore
  - d) dividend i pagueshëm
  - e) letra me vlerë bartëse të interesit
  - f) të drejta të arkëtueshme
  - g) tatim fitimi i arkëtueshëm/pagueshëm
  - h) të drejta të arkëtueshme nga qiraja financiare

Përgjigja e saktë është alternativa B

8. Tregoni se cila nga alternativat ne vijim është e sakte: Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve do të njihen kur:
- a) njësi ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve;
  - b) Kur pronësia ligjore kalon tek blerësi por blerësi ka të drejta ta kthejë në rast kalimi afati skadence
  - c) njësi ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;
  - d) shumica e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
  - e) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësi ekonomike;
  - f) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri
  - g) (A), (C)(D) (E) (F)
  - h) A), (B) (C)(D)

Përgjigja e saktë është alternativa G

9. Sipas SNK 16 “ Aktivet Afatgjata Materiale (Toka, Ndërtesa, Makineri e Pajisje)”, matja dhe njohja, cilët prej sa me poshtë konsiderohen shembuj të kostove drejtpërdrejt të atribueshme ?
- a) kostot e përfitimeve të punonjësve (siç përcaktohet në SNK 19 Përfitimet e punonjësve) që vijnë drejtpërdrejt nga ndërtimi ose blerja e zërit të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)
  - b) kostot e përgatitjes së vendit
  - c) kostot e lëvrimin dhe transportit fillestar
  - d) kostot e vënies në punë dhe bashkimit
  - e) kostot e testimit nëse aktivi funksionon si duhet pas zbritjes së të ardhurave neto nga shitja e çdo zëri të prodhuar ndërsa aktivi vjen në vend dhe në ato kushte (të tillë si kampionët e prodhuar për të testuar pajisjen)
  - f) tarifat profesionale.
  - g) Te gjitha me lart
  - h) Asnje nga me lart

Përgjigja e saktë është alternativa G

10. Sipas SNK 1 “ Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, cila prej alternativave me poshte eshte e vertete ne lidhje me parimin e Vijimsise?
- a) Kur përgatit pasqyrat financiare, drejtimi duhet të bëjë një vlerësim të aftësisë së njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimësi.
  - b) Pasqyrat financiare duhet të përgatiten mbi bazën e vijimësisë me përjashtim të rasteve kur drejtimi synon të likujdohë njësinë ekonomike, ose të ndërpresë veprimtarinë e saj, ose kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër realiste përveç se të veprojë në këtë mënyrë.
  - c) Kur njësia nuk përgatit pasqyra financiare në bazë të parimit të vijimësisë, ky fakt duhet të jepet në informacionet shpjeguese, së bashku me bazën sipas të cilës janë përgatitur pasqyrat financiare dhe arsyen pse njësia ekonomike nuk shihet në vijimësi
  - d) Për të vlerësuar nëse supozimi i vijimësisë është ose jo i përshtatshëm, drejtimi i njësisë ekonomike duhet të mbajë parasysh të gjithë informacionin e vlefshëm për të ardhmen, që si periudhë është të paktën, por që nuk kufizohet vetëm në të, 12 muaj nga fundi i periudhës raportuese.
  - e) Te gjitha me lart
  - f) Vetem 1 dhe 2
  - g) Vetem 2 dhe 3
  - h) Asnje nga me lart

Përgjigja e saktë është alternativa E

## **PYETJE ME SHITJELLIM (4 pikë secila pyetje)**

1. Cilat janë kriteret që një njësi ekonomike të klasifikohet si mikro-njësi? Cilat janë pasqyrat financiare që kerkohen të hartohen prej mikronjësive?

Zgjidhje:

Mikronjësi ekonomike - njësitë ekonomike, që në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kriterëve të mëposhtme:

- a) aktivi, 15 milionë lekë nese periudha e raportimit është deri në 2021; 25 milion lekë per vitin 2022;
- b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 30 milionë lekë; nese periudha e raportimit është deri në 2021; 50 milion lekë per vitin 2022;
- c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 10 punonjes.

Pasqyrat financiare të kërkuara prej mikronjësive, janë:

a. kur përdorin kontabilitetin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara:

1. Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve (PASH),
3. Shënimet Shpjeguese

b. kur përdorin kontabilitetin mbi baza monetare:

1. Pasqyra e Arkëtimeve dhe Pagesave

Mikronjësitë të cilat zbatojnë kontabilitetin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara lejohen të ndërtojnë edhe pasqyra të tjera me qëllim përmirësimin e transparencës dhe të cilësisë së informacionit që paraqesin (p.sh mund të përfshihet pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe / ose pasqyra e lëvizjes së kapitalit). Pasqyrat financiare vjetore paraqesin informacionet e mëposhtme: (a) emrin e mikronjësisë ekonomike dhe të dhëna të tjera identifikuese, si dhe ndonjë ndryshim në këto të dhëna nga pasqyrat e mëparshme; (b) datën e ndërtimit të pasqyrave ose periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, në varësi se cila nga këto është më e përshtatshme; (c) monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare (lekë); (d) shkallën e rrumbullakimit të shumave të paraqitura në pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare paraqiten dhe publikohen të paktën një herë në vit. Pasqyrat financiare përfshijnë edhe të dhënat krahasuese me vitin e mëparshëm.

2. Shpjegoni pse rritja e shpejtë e totalit të shitjeve mund të mos jetë domosdoshmerisht një gjë e mirë për një njësi ekonomike. Cilet jane treguesit e tjere te PF qe duhen analizuar?

Zgjidhje:

Shitjet totale mund të rriten si rezultat se një kompani shet më shumë në dyqanet e saj ekzistuese, ose mund të rriten si rezultat i hapjes së dyqaneve të reja. Rritja e nxitur nga shitjet e dyqaneve të reja mund të errësojë faktin që dyqanet ekzistuese nuk po plotësojnë nevojat e klientëve dhe po përjetojnë rënie të shitjeve. Analistët duhet të vlerësojnë shitjet për të përcaktuar se çfarë po shkakton ndryshime nga periudha në periudhë. Ata nuk duhet të supozojnë se një rritje është gjithmonë një lajm i mirë.

Ndaj analiza duhet të fokusohet dhe në raporte të tjera të cilat fokusohen në vlerësimin e efikasitetit të një njësie ekonomike në përdorimin e aktiveve të saj.

Raporti i kthyeshmerisë së aktiveve totale i cili vlerëson sa mirë i shfrytëzon një njësi ekonomike aktivet e saj për të gjeneruar të ardhura.

Raporti i kthyeshmerise se aktiveve afatgjata materiale i cili vlereson sa mire i shfrytëzon nje njesi ekonomike aktivet e saja afatgjata per te gjeneruar te ardhura.

Raporti i kthyeshmerise i llogarive te arketueshme i cili tregon aftesine e njesise ekonomike per te arketuar ne menyre efikase llogarite e arketueshme.

Raporti i kthyeshmerise se inventarit nepermjet te cilit vleresohet aftesia e njesise ekonomike per te shitur inventarin e saj.

3. Bazuar në kërkesat e SKK 2, cfarë informacioni duhet të paraqitet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare mbi palët e lidhura dhe veprimet me to?

Zgjidhje:

Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm mbi palët e lidhura dhe veprimet me to:

- (a) emri i njësisë (për shembull, njësia mëmë ose një person që zotëron shumicën e aksioneve) që kontrollon njësinë ekonomike, si dhe emri i njësisë mëmë që kontrollon të gjithë grupin;
- (b) llojin dhe volumin e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit si dhe shpërblimin total të dhënë stafit drejtues dhe anëtarëve të organit mbikëqyrës;
- (c) gjendjen e llogarive ku janë përfshirë transaksionet me palët e lidhura, në datën e pasqyrës së pozicionit financiar;
- (d) politikat e çmimeve të aplikuara në transaksionet me palët e lidhura.

4. Në Janar 2022, Paridi Sha një shoqëri që operon në tregun hotelier mori me qira një furgon për stafin e saj nga shoqëria Albania Lease Sha, për 3 vite dhe për të cilën duhet të kryejë pagesat prej 12,000 dollarë në vit. Kjo pagesë përfshin edhe shërbimet e mirëmbajtjes. Paridi Sha mund të marrë me qira të njëjtin furgon për një pagesë prej 11,000 dollarë dhe do duhet të paguajë 2,000 dollarë në vit për shërbimet e mirëmbajtjes.

Në vijim Albania Lease Sha jep me qira një pronë një qiramarrësi nën një qira operative për 5 vjet me një normë vjetore prej 100,000 dollarë. Megjithatë, kontrata thekson se 6 muajt e parë janë “pa qira”.

#### **Kërkohet:**

Argumentoni trajtimin kontabël që do të zbatohet Paridi Sha për qiramarrjen e mesipërme sipas SKK; Argumentoni trajtimin kontabël që do të zbatohet Albania Lease Sha për qiradhëniën e pronës dhe të ardhurat që do të njoh në vitin e parë dhe vitin e fundit (mos konsideroni efektin në kohë të parësë);

Zgjidhje:

a) Një kontratë mund të përmbajë më shumë se një elementë dhe konsiderohet një kontratë shumë elementëshe, në rastin e Paridi sha përmban një komponent qiraje ashtu edhe një komponent jo-qiraje, pra përfshinë një shumë të pagueshme nga qiramarrësi për aktive apo shërbime që nuk kanë në thelb transaksionin e qerasë. Këto aktivitete dhe kosto mund të përfshijnë, për shembull, mirëmbajtjen, riparimin ose pastrimin. Skk7 dhe Ifrs15 kërkon që njësitet ekonomike të kontabilizojnë përbërësin e qirasë të kontratës veçmas nga përbërësi jo-qira. Shuma në kontratë shpërndahet në bazë të çmimeve të pavarura të përbërësit/komponentit/eve të qirasë

dhe përbërësit/komponentëve jo-qira. Përderisa këto komponentë identifikohen vecmas dhe njësia i jep edhe si shërbime të pavarura atëherë duhet bërë ndarja e tyre si më poshtë:

Paridi sha do të ndajë 10,154 \$ ( $12,000 \$ \times 11,000 \$ + \$ (11,000 + 2,000)$ ) për komponentin e qirasë dhe do ta trajtojë atë si qira të zakonshme ose financiare sipas kushteve dhe kërkesave që duhen plotësuar sipas Skk 7. Paridi sha do të ndajë 1,846 \$ ( $12,000 \$ \times 2,000 \$ + \$ (11,000 + 2,000)$ ) për shërbimin e mirmbajtjes dhe ta njohin atë në rezultat si shpenzim në varësi të mënyrës se si do të merret ky shërbim.

b) Pagesat e qirasë sipas qirave operative njihen si të ardhura ose mbi bazën lineare/graduale ose një bazë tjetër sistematike (nëse është më përfaqësuese e modelit në të cilin përfitimi nga përdorimi i aktivitetit të dhënë me qera përfitohet)

Përfitimi i marrë nga aktivi fitohet gjatë 5 viteve. Megjithatë, në vitin e parë, qiradhënësi merr vetëm 100,000 dollarë  $\times 6/12 = 50,000$  dollarë. Qiratë në total prej 450,000 dollarë (50,000 dollarë + (100,000 dollarë  $\times 4$  vjet)) merren gjatë afatit të qirasë 5-vjeçare. Prandaj, qiradhënësi njihet të ardhura prej 90,000 dollarë në vit (450,000 dollarë/5 vjet). Një llogari e arkëtueshme prej \$40,000 njihet në fund të vitit 1 (\$90,000-\$50,000). Kjo llogari do të zvogelohet çdo vit në vlerën 10,000 dollarë.

5. Paraqitni objektivin e standardit ndërkombëtar SNRF12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike” dhe pse rëndësia e tij theksohet në rastin e krizave financiare dhe skandaleve të raportimit financiar.

Zgjidhje:

Objektivi i standardit është t'i kërkojë një njësie raportuese të japë informacion shpjegues që i mundëson përdoruesit të pasqyrave financiare të vlerësojë natyrën dhe rreziqet që lidhen me interesat në njësitë e tjera ekonomike dhe efektet e këtyre interesave në pozicionin e saj financiar, performancën financiare . dhe në flukset monetare (SNRF 12: para. 1).

Dhënia e informacioneve shpjeguese kryesore të kërkuara nga SNRF 12 për një njësi ekonomike që ka investime në njësi ekonomike të tjera janë:

- (a) Gjakimet dhe supozimet e rëndësishme të bëra në përcaktimin nëse njësia ekonomike ka kontroll, kontroll të përbashkët ose ndikim të rëndësishëm mbi njësitë e tjera ekonomike, dhe në përcaktimin e llojit të marrëveshjes së përbashkët (SNRF 12: para. 7)
- (b) Informacion për të kuptuar përbërjen e grupit dhe interesin që kanë interesat jo kontrolluese në aktivitetet dhe flukset monetare të grupit (SNRF 12: para. 10)
- (c) Natyrën, shtrirjen dhe efektet financiare të interesave në marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet, duke përfshirë natyrën dhe efektet e marrëdhënieve kontraktuale të njësisë ekonomike me investitorët e tjerë (SNRF 12: para. 20)
- (d) Natyrën dhe shtrirjen e interesave në njësitë ekonomike të strukturuar të pakonsoliduara (SNRF 12:para. 24)
- (e) Natyrën dhe shtrirjen e kufizimeve të rëndësishme mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të aksesuar ose përdorur aktivitetet dhe për të shlyer detyrimet e grupit (SNRF 12: para. 10)

(f) Natyra dhe ndryshimet në rreziqet që lidhen me interesat e njësisë ekonomike në njësitë ekonomike të strukturuar të konsoliduara, sipërmarrjet e përbashkëta, pjesëmarrjet dhe njësitë ekonomike të strukturuar të pakonsoliduara (p.sh. angazhimet dhe pasivet e kushtëzuara) (SNRF 12: para. 10, 20, 24)

(g) Pasojat e ndryshimeve në interesin e pronësisë së njësisë ekonomike në një filial që nuk rezultojnë në humbjen e kontrollit (dmth. efektet në kapitalin neto që i atribuohen pronarëve të shoqërisë mëmë) (SNRF 12: para. 10, 18)

(h) Pasojat e humbjes së kontrollit të një filiali gjatë periudhës raportuese (p.sh. fitimi ose humbja, dhe pjesa e saj që lidhet me matjen e çdo investimi të mbetur me vlerën e drejtë, dhe zërat e linjës në fitim ose humbje në të cilat fitimi ose humbja njihet nëse nuk paraqitet veçmas (SNRF 12: para. 10, 19).

Duke konsideruar objektivin dhe shënimet shpjeguese që duhen dhënë sipas Snrf-12 kuptohet rëndësia pasi është një standart i cili te detyron të japësh informacion të detajuar dhe i jep përdoruesit të pasqyrave financiare pamjen e plotë dhe të qartë të njësisë ekonomike raportuese.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në dritën e krizës financiare dhe skandaleve të fundit të kontabilitetit. BSNK beson se informacioni më i mirë në lidhje me interesat në njësitë ekonomike të tjera është i nevojshëm për të ndihmuar përdoruesit e pasqyrave financiare të identifikojnë fitimin ose humbjen dhe flukset monetare të disponueshme për njësinë ekonomike raportuese dhe për të përcaktuar vlerën e një investimi aktual ose të ardhshëm në njësinë ekonomike raportuese.

6. Në lidhje me disa transaksione që ka kryer Njësia A gjatë vitit 2022 zotërohet ky informacion:

- Ka marrë në 5 qershor 2021 dhuratë nga Bashkia e qytetit një tokë me kushte që ajo të ndërtojë një kompleks sportiv për komunitetin . Vlera e tregut e tokës vlerësohet të jetë 3.6 milion leke. Shoqëria e përfundon ndërtimin e kompleksit sportiv në 31.12.2021 dhe pati një kosto pa vlerën e tokës prej 2.4 milion leke. Drejtimi i shoqërisë vlerëson që kompleksi sportiv do të përdoret për 10 vjet.

-Njësia A ka marrë nga Bashkia një grant për 3 autobusë elektrikë për tu përdorur në 2 linja urbane dhe 1 interurbane. Totali i vlerës së autobusëve është 9 mil leke. Kontrata e grantit parashikon që shoqëria do të përdorë këto autobuzat në linjat përkatëse të paktën për 3 vjet. Në rast të kundërt duhet të kthejë vleftën e plotë të grantit të dhënë prej 9 milion leke. Drejtimi i shoqërisë, pasi ka vlerësuar tregun përkatës, nuk ka siguri nëse do të jetë në gjendje të përdorë autobuzët për 3 vite.

**Kërkohet:** Tregoni si do të trajtohen këto situata në kontabilitetin e njësisë A sipas SKK-ve?

Zgjidhje:

Në rastin e parë Njësia A ka marrë një grant një AAM (tokë) të kushtëzuar vetëm për tu përdorur për ndërtimin e kompleksit sportiv. Shoqëria e ka realizuar ndërtimin e kompleksit dhe prandaj do të njohe shumën e grantit për token në periudhat kur pritet të merren përfitimet nga përdorimi i aktivitetit (kompleksi sportiv). Pra shoqëria do të njohe vleftën e tokës me vlerën e drejtë dhe po me këtë shumë do të njihet edhe Granti si e ardhur e shtyre, pra për tu shpërndarë, për vlerën 3.6 milion leke. Këtë shumë pastaj Njësia A do ta shpërndajë në të ardhurat gjatë periudhës kur përdoret kompleksi sportiv, pra për 10 vjet.

Në rastin e dytë Njësia A ka marrë një grant të kushtëzuar me performancën, pra me përdorimin për 3 vite të autobusëve. Shoqëria nuk ka sigurinë që do të realizojë këtë kusht prandaj do të njohe



Shumen e grantit 9 milion lekë si një detyrim ne Pasqyrat financiare (DAGJ). Nëse shoqëria do te realizojë këtë detyrim, pra pas 3 vitesh, atëherë ajo do te njohe Shumen e Grantit nga Detyrim Afatgjate ne Kapitalet e veta (Kapital i dhuruar), dhe pastaj do ta shpërndajë ne te ardhurat ne masën e shpenzimit te amortizimit te autobuzëve.

7. Përshkruani sipas SKK 9 situatat kur një njësi ekonomike investuese ka kontrollin mbi një njësi tjetër.

*Kërkohe:* Tregoni Çfarë parashikon SKK 9 kur një njësi ekonomike mëmë nuk duhet te ndërtojë PF te konsoliduara.

Zgjidhje:

Kontrolli është fuqia për të qeverisur politikat e shfrytëzimit dhe financiare të një njësie në mënyrë që të sigurojë përfitime nga veprimtaritë e saj. Kontrolli presupozohet se ekziston kur njësia mëmë zotëron në mënyrë direkt ose të tërthortë (nëpërmjet njësive të kontrolluara prej saj) më shumë se gjysmën e të drejtës votuese të njësisë së kontrolluar, përveç rasteve përjashtimore, kur mund të tregohet qartë që një zotërim i tillë nuk përbën kontroll.

Kontrolli ekziston gjithashtu kur njësia mëmë zotëron gjysmën ose më pak se gjysmën e të drejtës votuese të njësisë së kontrolluar, kur ka : (a) pushtet mbi më shumë se gjysmën e të drejtës votuese, nëpërmjet një marrëveshjeje me investitorë të tjerë; (b) pushtet për të drejtuar politikat financiare dhe të shfrytëzimit të njësisë ekonomike, sipas statutit të njësisë ose një marrëveshjeje; (c) pushtet për të emëruar ose shkarkuar shumicën e anëtarëve të stafit drejtues dhe organit më të lartë mbikëqyrës (për shembull bordin drejtues dhe bordin e mbikëqyrjes së shoqërisë); (d) pushtet për të përcaktuar shumicën e votave në procesin e vendimmarrjes së bordit të drejtorëve dhe organit më të lartë të mbikëqyrjes.

Një shoqëri mëmë nuk duhet të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara nëse:

(a) plotësohen të dyja kushtet vijuese:

(i) shoqëria mëmë është vetë një njësi e kontrolluar dhe,

(ii) shoqëria mëmë përfundimtare e saj (ose ndonjë shoqëri mëmë e ndërmjetme) përgatit pasqyra financiare të konsoliduara të qëllimit të përgjithshëm që pajtohen me të gjitha SKK-të ose me këtë SKK; ose

(b) ajo nuk ka njësi të kontrolluara përveç atyre të blera me qëllimin e shitjes ose mbylljes brenda një viti. Një shoqëri mëmë duhet ta kontabilizojë këtë njësi të kontrolluar me kosto minus zhvlerësimin.

8. Një njësi ekonomike kultivon një lloj të veçantë lënde drusore me rritje të shpejtë në një cikël 10-vjeçar rritjeje. Njësia ekonomike është një prej shumë fermerëve që rrisin të njëjtin lloj druri pishë në një zonë të gjerë me tokë të ngjashme. Njësia ekonomike (si shumë nga konkurrentët e saj) përdor shërbimet e specialistëve vendorë në mbjelljen e pishave në tokën e saj. Specialistët përgatisin tokën, sjellin fidanët, plehun, lëndët kimike të tjera si dhe ujin, dhe mbjellin fidanët. Pasi mbillen pemët, njësia ekonomike menaxhon dhe mirëmban plantacionet e saj (plehërimin dhe ujitjen, shpërndarjen dhe spërkatjen me mjete kimike) për të optimizuar rritjen e drurit. Në tregun vendor ka shitje të vazhdueshme të plantacioneve të pishës thelbësisht homogjene (pemët dhe toka në të cilën ato janë mbjellë). Shitjet realizohen me ankande, dhe çmimet janë të publikuara. Njësia ekonomike i klasifikon plantacionet e saj të pishës në dy kategori: të maturuara (katër vjet ose më shumë) dhe të pamaturuara (tre vjet ose më pak).

Përshkruani çfarë modeli matjeje mund të përdorë njësia ekonomike sipas SKK 13.

### Zgjidhje:

Njësia ekonomike zbaton modelin e vlerës së drejtë për të matur aktivet biologjike të pyjeve me pisha (të maturuara dhe të pamaturuara), sepse vlera e drejtë e tyre është lehtësisht e përcaktueshme pa kosto apo përpjekje të panevojshme.

9. Njësia ekonomike A (qiramarrësi) lidh një kontratë qiraje 10-vjeçare të një ndërtese me 10 kate nga njësia ekonomike B. Në datën e fillimit të qirasë kryesore, qiramarrësi njuh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim përkatës qiraje për 10 katet për 10 vitet.

Një vit më vonë, njësia ekonomike A i jep me qira tre nga 10 katet njësisë ekonomike C për:

- Skenari 1 – 8 vite
- Skenari 2 – 3 vite

Per secilin skenar vleresoni:

- a) A është nënqiraja qira operative apo qira financiare?
- b) Çfarë ndodh me aktivin me të drejtën e përdorimit?

### Zgjidhje:

#### *Skenari 1*

- a) Afati i nënqirase mbulon pjesën më të madhe të qirase kryesore (8 nga 9 vite të mbetura), prandaj duke mos pasur evidence të kriterëve të tjera, nënqiraja do të klasifikohet si qira financiare
- b) Aktivi me të drejtë përdorimi për 3 katet e dhëna me nënqira do të regjistrohët. Do të njihet një e drejtë e arketushme nga qiraja financiare për 3 katet. Detyrimi I qirase kryesore për 10 katet nuk regjistrohët. Aktivi me të drejtë përdorimi për 7 katet që nuk jepen me qira vazhdon të jetë I regjistruar.

#### *Skenari 2*

- a) Afati i nënqirase nuk mbulon një pjesë të madhe të qirase kryesore (3 nga 9 vite të mbetura), prandaj duke mos pasur evidence të kriterëve të tjera, nënqiraja do të klasifikohet si qira operative
- b) Aktivi me të drejtë përdorimi për 3 katet e dhëna me nënqira do të riklasifikohët si Aktive të Investuara (SNK 40). Detyrimi I qirase kryesore për 10 katet nuk regjistrohët. Aktivi me të drejtë përdorimi për 7 katet që nuk jepen me qira vazhdon të jetë I regjistruar.

10. Sipas SNK 8” “ Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabime” perkufizoni termat dhe kur zbatohen: zbatim retrospektiv dhe zbatim prospektiv.

### Zgjidhje:

Zbatim retrospektiv është zbatimi i një politike të re kontabël për transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera sikur kjo politikë të ishte **zbatuar përgjithmonë**.

Zbatimi prospektiv i një ndryshimi në politikat kontabël dhe njohja e efektit të një ndryshimi në një vlerësim kontabël, përkatësisht, janë:

- (a) zbatimi i një politike të re kontabël ndaj transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera që ndodhën **mbas datës në të cilën u ndryshua politika**; dhe
- (b) njohja e efektit të ndryshimit në vlerësimin kontabël **në periudhën aktuale dhe ato të ardhshme** që ndikohen nga ndryshimi.

## USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)

### Ushtrimi 1

Shoqeria ABC ka aktive afatshkurtra në Shumen 90.000 leke dhe detyrime afatshkurtra në shumen 180.000. Llogaritni efektin që ka secili prej transaksioneve në raportin korrent të shoqërisë:

- Rfinansimi i një borxhi afatgjatë prej 30.000 lekë me një deftesë aftshkurtër;
- Blerja e inventarit me vlere 50.000 leke me pagese te mevonshme;
- Likuidimi i shumës 20.000 lekë nga llogari të pagueshme afatshkurtra;
- Arkëtimi prej 10.000 lekë nga klientët.

Zgjidhje:

AASH = 90.000  
DASH = 180.000

**Rap Korrent=AASH/DASH=90000/180000 = 0.5 ose 50%**

A) Rap korrent =  $90000 / (180000 + 30000) = 0.43$  ose 43% (ulje me 7%)

B) Rap korrent =  $(90000 + 50000) / (180000 + 50000) = 0.6$  ose 60% (rritje me 10%)

C) Rap korrent =  $(90000 - 20000) / (180000 - 20000) = 0.43$  ose 43% (ulje me 7%)

D) Rap korrent =  $(90000 + 10000 - 10000) / 180000 = 0.5$  ose 50% (nuk ndryshon)

### Ushtrimi 2

Në fund të vitit, Software City filloi të mbante WordCrafter, një program i ri software-ësh për përpunimin e tekstit. Më 31 dhjetor, të dhënat e inventarit kishin stok si vijon:

Data e Blerjes	Njësitë e blera	Cmimi në Dollar	Kosto Totale
14 nëntor	8	400	3,200
12 dhjetor	20	310	6,200
<b>Total</b>	<b>28</b>		<b>9,400</b>

Më 31 dhjetor, Software City bën një inventar fizik dhe zbulon se të gjitha 28 njësitë e WordCrafter janë në rregull dhe aty. Megjithatë, kostoja aktuale e zëvendësimit (çmimi me shumicë) i këtij produkti është vetëm 250 dollarë për njësi.

Përgatitni regjistrimet për:

- a) Matjen e vlerës së inventarit në fund sipas SKK 4.
- b) Shitja me para në dorë e 15 programeve WordCrafter më 9 janar, me një çmim prej 350 dollarë secili. Supozoni se Software City përdor FIFO.
- c) Supozoni se kostoja aktuale e zëvendësimit të programeve WordCrafter është 405 dollarë secila. Nga inventari fizik gjen vetëm 25 prej këtyre programeve në dispozicion më 31 dhjetor.

Zgjidhje:

- a) Sipas SKK 4, Inventarët në vlerësimin e mëpasshëm vlerësohen me më të ultën midis koston dhe VNR. Duke qenë se njësitë e blera dhe të identifikuarat specifikuara janë të zhvlerësuara, atëherë 8 njësitë e datës 14 nëntor do të duhen që të zhvlerësohen me 150\$ për njësi, në total 1200\$ zhvlerësim, dhe kosto e tyre në fund do të jetë 2000\$; ndërsa 20 njësitë e datës 12 dhjetor do të zhvlerësohen me 1200\$ (60\$ zhvlerësim për njësi), dhe kosto e tyre në fund do të jetë 5000\$. Në total, Software City duhet të njohë një zhvlerësim prej 2400\$, dhe kosto e inventarit në fund do të jetë 7000\$.

Debi: Fitim ose humbje – Humbje nga zhvlerësimi inventarit	2400
Kredi: Zhvlerësim Inventari (si kundërlllogari e inventarit)	2400

- b) Debi: Kosto e mallrave të shitura 5,370  
Kredi: Inventar 5,370

Kosto e mallrave të shitura është llogaritur duke përdorur FIFO, ku 8 njësi do të kenë një kosto prej 400 dollar për njësi dhe 7 njësi do të ketë një kosto 310 dollar. Vlera e inventarit në fund do të jetë 310 dollar për njësi dhe 13 njësi të mbetura, në total 4,030 dollar.

- c) Në këtë rast, do të njohim një humbje për tre njësitë që nuk janë gjendje, Në lidhja me matjen e mëpasshme, sipas SKK 4, Inventarët në vlerësimin e mëpasshëm vlerësohen me më të ultën midis koston dhe VNR, në rastin konkret nuk ka nevojë për zhvlerësim. Pra, inventari do të zhvlerësohet si vijon duke supozuar që 3 njësitë e humbura janë nga kategoria e parë prej 400 dollar për njësi:

Debi: Fitim ose humbje – Humbje nga humbja e inventarit	1200
Kredi: Inventari	1200

Inventari në fund do të kishte një vlerë në raportim prej  $5 \times 400 + 20 \times 310 = 8200$  dollar.

### Ushtrimi 3

Një instrument borxhi ka një shumë të deklaruar principali prej 50,000 Euro, i cili do të shlyhet në pesë vite me një normë interesi prej 6% në vit, e pagueshme çdo vit, në fund të çdo viti. Njësia ekonomike e blen instrumentin më 1 janar 2021, me një zbritje për vlerën 46,700 euro. Njësia ekonomike e klasifikon letrën me vlerë të borxhit si të mbajtur deri në maturim. Norma efektive e interesit të investimit në letrat me vlerë të

borxhit është afërsisht 7.65%. Kjo është norma e skontimit që do të japë një vlerë aktuale të flukseve monetare të ardhshme që është e barabartë me çmimin e blerjes.

- a) Bëni regjistrimet kontabël më datë 1 janar 2021 të instrumentit të borxhit të blerë me zbritje sipas SKK
- b) Bëni regjistrimet kontabël rregulluese në 31.12.2021 dhe 31.12.2022 në lidhje me termat e borxhit

**Zgjidhje:**

a) Debi: Instrument borxhi	50,000
Kredi: Mjete monetare	46,700
Kredi: Zbritja e instrumentit të borxhit	3,300

- b) Bazuar te norma 7.65%, në 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2021, do të bëhet regjistrimi:

Debi: Mjete monetare	3,000 (6% x 50,000)
Debi: Instrument borxhi – amortizimi i zbritjes	570 (diferenca e amortizimit të primit)
Kredi: Të ardhura nga interesi	3,570 (7.65% x 46700)

**Ushtrimi 4**

Eveline sha është një njësi ekonomike që operon në industrinë e modës, periudha kontabël e saj është vjetore dhe mbyllet më datë 31 Maj. Eveline ka filluar të zhvillojë markën e saj “Ev-On” në veshjet sportive. Shpenzimet për periudhën që mbyllet më 31 Maj 2022 janë si më poshtë:

<i>Periudha</i>	<i>Shpenzimi</i>	<i>Vlera-mln lekë</i>
01 qershor 2021-31 gusht 2021	Studim për shtrirjen e tregut	3
01 shtator 2021-30 nëntor 2021	Prototipi i veshjeve dhe dizajni i tyre	4
01 dhjetor 2021-31 janar 2022	Shpenzime për personelin në përsosjen e produktit	2
01 shkurt 2022-30 prill 2022	Shpenzime për finalizimin e dizajnit të produktit	5
01 maj 2022-31 maj 2022	Prodhimi dhe hedhja në treg e produkteve	6
		20

Në koston e prodhimit dhe hedhjes në treg të produkteve përfshihet kostoja e përmirësimit të linjës së prodhimit ekzistuese (3 mln lekë), kosto për studim tregu (2 mln lekë) dhe trajnimi i stafit (1 mln lekë). Kontabilisti e ka përfshirë totalin e shpenzimeve në vlerën 20 mln lekë si aktiv afatgjat jomaterial.

**Kërkohet:** Tregoni me llogaritje dhe argumentoni nëse ka vepruar saktë kontabilisti i Eveline sha dhe nëse jo si do të ishte paraqitja e saktë e shpenzimeve të mësipërme në pasqyrat financiare për vitin që mbyllet më 31 Maj 2022.

**Zgjidhje:**

SKK 5 ndan një projekt zhvillimi në fazën e kërkimit dhe në fazën e zhvillimit. Në fazën e kërkimit të një projekti, një njësi ekonomike nuk mund të demonstrojë ende se shpenzimet do të gjenerojnë përfitime të mundshme ekonomike në të ardhmen. Prandaj, shpenzimet për kërkimin duhet të njihen si shpenzim periudhe kur ato ndodhin.

Shpenzimet për krijimin e një Aktivi Jomaterial fillojnë të kapitalizohen kur ato kryhen në fazën e zhvillimit dhe plotësohen njëherazi kushtet e mëposhtëme:

- Përfitime ekonomike të mundëshme në të ardhmen;
- Qëllimi për të realizuar këtë AJM;
- Burimet e nevojshme dhe të mjaftueshme për ta realizuar këtë AAJM;
- Aftësia për ta përdorur këtë AAJM;
- Aftësia teknike për ta realizuar këtë AAJM;
- Matja e kostos në mënyrë të besueshme.

Duke supozuar se plotësohen të gjitha këto kritere, kostoja e zhvillimit duhet të përfshijë të gjitha kostot që lidhen drejtpërdrejt me to, të nevojshme për krijimin e aktivit dhe për ta bërë atë të aftë të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Kostot e shitjes ose administrative, ose kostot e trajnimit ose kërkimit të tregut nuk përfshihen në vlerën e Aktivit jo-material. Kostoja e përmirësimit të makinerive ekzistuese do të trajtohet sipas kërkesave të Skk5.

Prandaj, shpenzimet për projektin duhet të trajtohen si më poshtë:

<i><b>Kostot</b></i>	<i><b>Shpenzim periudhe</b></i>	<i><b>Aktiv jo-material</b></i>	<i><b>Aktiv afatgjatë-Skk5</b></i>
studim për shtrirjen e tregut	3		
prototipi I veshjeve dhe design i tyre		4	
shpenzime për personelin në përsosjen e produktit		2	
shpenzime për finalizimin e dizjanit të produktit		5	
prodhimi dhe hedhja në treg e produkteve			
përmirësimit të linjës së prodhimit ekzistuese			3
kosto për studim tregu	2		
trajnimi i stafit	1		
<b>Total</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>3</b>

*Pra vlera që duhet të njohë është 11 dhe jo 20.*

## **Ushtrimi 5**

Njësia ABC shet produkte të ndryshme. Për të nxitur shitjet e një grupi produktesh B të ri, ajo ju ofron klientëve të vet që nëse ata blejnë një sasi prej këtij grupi prej 200 mijë lekë, do të marrin edhe 2 Produkte A falas. Çmimi i shitjes së Produktit A është në treg 10 mijë lek për cope. ABC i ka shitur një Distributori D një sasi nga ky grup produkti B prej 400 mijë lekësh duke përfituar kështu edhe 4 cope produkti A falas.

**Kërkohet:** Tregoni si do te trajtohet ky transaksion sipas SKK 8.

**Zgjidhje:**

Sipas SKK 8 kur njësia ekonomike se bashku me mallrat jep falas një sasi te caktuar mallrash atëherë ajo do ta trajtojë mallrat falas si një përbërës të veçantë të identifikueshëm të transaksionit fillestar të shitjes. Njësia ekonomike do të shpërndajë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar në lidhje me shitjen fillestare midis mallrave me çmimin dhe mallrave falas. Shuma e shpërndarë tek mallrat falas do të matet duke iu referuar vlerës së tij të drejtë, d.m.th. shumës me të cilën mallrat falas mund të shiten veçmas.

ABC i ka dhënë klientit një opsion që i jep një të drejtë materiale, që e fiton vetëm mqs po realizon këtë kontratë blerje. Distributori D e përfiton këtë të drejtë mqs e ka zbatuar opsionin. Si pasojë ai do të marrë edhe 4 cope produkti A falas. Pra ABC çmimin e transaksionit, 400 mijë lekë do të shpërndajë midis grupit të Produkteve A dhe produktit B, bazuar në çmimet specifike të tregut të tyre.

Raporti do të jetë  $40,000/440,000 = 9\%$ .

Kështu që çmimi 400 mijë lekë do të ndahet  $400,000 \times 91\% = 364,000$  - janë të ardhurat nga shitja e Produktit B, dhe  $400,000 \times 9\% = 36,000$  janë të ardhurat që do të njohë nga shitja e produktit A.

## Ushtrimi 6

Shoqëria A bleu ne 1 Prill 2022 biznesin e bareve Magic të një konkurenti (shoqërisë B) që u paguan me 200AZ te saja në datën e blerjes. Vlera nominale e aksioneve ishte 5,000 Lek/AZ dhe vlera e Tregut 5,900 Leke/AZ Blerja u realizua përmes transferimit të aktiveve, detyrimeve dhe aktiviteteve të biznesit të bareve tek shoqëria A. Aktivet, detyrimet dhe detyrimet e kushtëzuara të biznesit të blerë në datën e blerjes janë:

	<i>Vlera kontabël</i> në pasqyrat financiare <b>lekë</b>	<i>Vlera e drejtë</i> të shoqërisë B <b>lekë</b>
Banka	50,000	50,000
Llogari te arkëtueshme	70,000	60,000
Pajisje	150,000	200,000
Liçensa Franshize	50,000	150,000
Marka (emri i regjistruar tregtar)	-	60,000
Llogari te pagueshme	120,000	110,000
Ndërtesa	500,000	550,000

Nga pajisjet e blera parashikon qe 50% te tyre ti shesë . Vlera e shitjes e parashikuar ishte 100,000 dhe shpenzimet e shitjes parashikon te jene 10,000 leke. Për realizimin e blerjes ka paguar një shoqëri konsulent K, qe ka bere identifikimin, procedurën dhe aktet e tjera ligjore te blerjes për 100,000 leke, dhe 50,000 leke do ti paguajë 1 muaj pas datës se blerjes. Shoqëria A parashikon qe te beje një ristrukturim te aktiviteti qe ka blere dhe parashikon një kosto prej 10,000 leke për ristrukturimin.

**Kërkohet:** (a) Tregoni trajtimin kontabël të këtij transaksioni sipas SKK.

(b) Tregoni trajtimin kontabël nëse blerja e rrjetit te restoranteve reve do te ishte paguar me AZ me vlere tregu 4,100 leke/AZ.

**Zgjidhje:**



(a) Ky transaksion do te trajtohet sipas SKK9. Shoqëria A ka blere aktivet neto te shoqërisë B, duke i paguar me AZ te saj me vlerën e tregut. Kosto e blerjes është 1,230,000 leke (200\*5,900+ 150,000) Përdor metodën kontabël te blerjes. Blerësi është shoqëria A. Data e blerjes është data 1 prill, kur ajo ka bere pagesën me AZ te saja. Aktivet e blera do ti paraqesë me vlerën e drejte ne datën e blerjes. Pajisjet qe do te shesë do ti paraqesë me vlerën e drejte minus kostot e parashikuara te shitjes. Do te njohe ne PF te saj edhe markën, megjithëse shoqëria B nuk e kishte ne kontabilitetin e saj. Po ashtu do te njohe edhe detyrimet qe parashikon ti dalin nga një çështje qe ka patur B me disa furnitorë te saj. Nga blerja me vlerën e tregut te Aksioneve 5,900 leke AZ rezulton një emër i mire,( i cili paraqitet si AAJM qe do te amortizohet për 10 vjet sipas SKK )sipas SNRF nuk amortizohet.

Regjistrimi kontabël do te jetë si vijon:

Banka	50,000	
Llogari Arkëtueshme	60,000	
Pajisje	100,000	
Pajise për shitje	90,000	
Licenca Franshizë	150,000	
Marka	60,000	
Ndërtesa	550,000	
Emri i Mire	390,000	
	Detyrimi kushtëzuar (Ristrukturim)	10,000
	Llogari e pagueshme	260,000
	AZ	1,000,000
	Primi AZ	180,000

b) Ne rastin nëse vlere e drejte nga AZ është 4,100 lek/AZ do te rezultojë një emër i mire negativ prej 120,000 leke qe do te njihet ne te ardhurat. : Kostoja e blerjes 200 AZ x4100 leke = 820,000 leke. VK e aktiveve neto te blera = 1,060,000-270,000=790,000. Emri i mire negativ = 30,000 leke.

## Ushtrim 7

Ne 1 janar 2022, nje njesi ekonomike, qe aplikon sipas SKK, blen aktive afatgjata materiale ne vleren 100,000 Lek me jete te dobishme 10 vite amortizim linear. Per qellime tatimore aktivet njihen si shpenzim ne momentin kur blihen.

Një njësi ekonomike njih një provizion për garanci prej 1,000 lekë për të mbuluar riparimin e artikujve të shitur të dëmtuar para mbylljes së vitit. Shuma e njohur si provizion nuk është e zbritshme për qëllime tatimore derisa ajo të paguhet ose përdoret.

Njësia ekonomike ka llogari të arkëtueshme bruto prej 50,000 lekë me një provizion për borxhe të këqija ose të dyshimta të krijuar për këtë llogari për 2,000 lekë. Provizionin për borxhe të këqija ose të dyshimta është i zbritshëm vetëm kur afati për shlyerjen e tij është vonuar me gjashtë muaj.

Njësia ekonomike ka një aktiv prej 1,000 lekë për interesin e arkëtueshëm në një depozitë bankare me norma të ndryshueshme. Interesi do të tatóhet kur të arkëtohen paratë.

Gjithashtu njësia ekonomike duhet të paguajë gjoba dhe penalitete në vlerën 5,000 lekë për shkeljen e ligjeve gjatë vitit të kaluar, të tilla si dorëzimi i vonuar i pasqyrave financiare. Njësia ekonomike ka njohur një detyrim për gjobat dhe penalitetet e pagueshme. Gjobat nuk janë të zbritshme për qëllime tatimore.

Supozoni një normë tatimi 20%.

**Kërkohet:** Llogarisni tatimin e shtyrë që lind për secilin nga rastet më sipër për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022.

**Zgjidhje:**

VKN e ndertesës me 31.12.2022 është 90,000 (100,000 – 100,000/10). Baza tatimore është 0 sepse kosto e ndertesës është njohur si shpenzim në periudhën aktuale. Në këtë rast lind një diferencë e perkohshme tatimore 90,000 lek. Detyrimi tatimor i shtyre është 18,000 lek (90,000 \* 20%)

Mënyra e pritshme e rikuperimit të detyrimit (d.m.th nëpërmjet pagesës së parave klientëve ose riparimit të artikujve të dëmtuar) do të ndikojë në fitimin e tatueshëm sepse çdo shpenzim për garancitë është i zbritshëm në momentin e pagesës ose të përdorimit. Si rrjedhim, lind një tatim i shtyrë i cili duhet të njihet. Baza kontabel e provizionit është 1,000 lek.

Baza tatimore e një detyrimi është vlera kontabel e tij, minus çdo shumë që do të jetë e zbritshme për qëllime tatimore në lidhje me atë detyrim në periudhat e ardhshme. Pra, baza tatimore e provizionit është 0 lek. Aktivit tatimor i shtyre është 200 lek (1,000 \* 20%)

Mënyra e pritshme e rikuperimit të llogarive të arkëtueshme (d.m.th me anë të arkëtimit të shumës së parave të barabartë me vlerën kontabel prej 48,000 lekë) do të ndikojë në fitimin e tatueshëm sepse 2,000 lekë do të jenë të zbritshme në momentin e rikuperimit të aktivitetit me vlerën e tij kontabel. Prandaj, tatimi i shtyrë duhet të njihet.

Baza kontabel e klienteve të arkëtueshëm është 48,000 lek.

Baza tatimore e një aktiviteti është shuma që do të zbritet kundrejt përfitimeve ekonomike të tatueshme nga rikuperimi i vlerës kontabel të aktivitetit. Pra, baza tatimore e klienteve është 50,000 lek. Aktivit tatimor i shtyre është 400 lek (2,000 \* 20%)

Mënyra e pritshme e rikuperimit të aktivitetit (d.m.th. përmes arkëtimit të parave) ndikon në fitimin e tatueshëm sepse shuma është e tatueshme kur arkëtohet. Si rrjedhim, lind një tatim i shtyrë i cili duhet të njihet.

Baza kontabel e interesit të arkëtueshëm është 1,000 lek.

Baza tatimore e një aktiviteti është shuma që do të zbritet kundrejt përfitimeve ekonomike të tatueshme nga rikuperimi i vlerës kontabel të aktivitetit. Pra, baza tatimore e interesit të arkëtueshëm është 1,000 lek.

Aktiviteti tatimor është 0.

Nga gjobat e pagueshme nuk krijohen të ardhura të tatueshme. Gjobat nuk janë shuma të zbritshme nga të ardhurat e tatueshme. Për këtë arsye, mënyra e pritshme e shlyerjes së detyrimit, përmes pagesës së gjobave, nuk ndikon në fitimin e tatueshëm dhe prandaj nuk lind asnjë tatim i shtyrë.

## Ushtrimi 8

Më 1 shtator 2022, Shoqëria Blokberger sh.p.k. bleu një makinë të re për përdorim në fabrikën e saj. Drejtorët kanë kapitalizuar çmimin e blerjes, por nuk janë të sigurt se si të trajtojnë sa vijon lidhur me shpenzimet e tjera.

- a-400,000 dollarë u shpenzuan për të testuar nëse makina po funksiononte siç duhet.
- b-Gjatë periudhës së testimit (shtator–tetor 2022), mostrat u prodhuan dhe u shitën për një total prej 75,000 dollarë.
- c-300,000 dollarë u shpenzuan gjithashtu për trajnimin e punonjësve ekzistues se si të funksionojnë makinerinë e re.
- d-Makina po përdoret për të prodhuar një produkt të ri, Produktin C dhe 1 milion dollarë janë shpenzuar për reklamimin e këtij produkti të ri.
- e-Testimi përfundoi dhe prodhimi komercial i Produktit C filloi më 31 tetor 2022.

**Kërkohet:** Sipas SNK 16” Aktivët Afatgjatë Materiale (Toka, Ndërtesa, Makineri e Pajisje)”, këshilloni Shoqërinë mbi trajtimin kontabël të makinerisë së re.

Zgjidhje:

### **Përgjigje e sugjeruar:**

Makina e re sipas SNK 16 “Aktivët afatgjatë materiale” kërkon kapitalizimin e çdo kostoje që i atribuohet drejtpërdrejt sjelljes së aktivitetit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë në gjendje të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Kërkohet testimi i makinës për t'u siguruar që ajo funksionon siç duhet përpara se makina të mund të përdoret në prodhim tregtar. Prandaj, sipas SNK 16, Blokberger duhet të **kapitalizojë** \$325,000 që janë kostot \$400,000 të testimit të funksionalitetit të aktivitetit **minus** të ardhurat neto prej \$75,000 nga shitja e artikujve të prodhuar duke sjellë aktivin në vendndodhjen dhe gjendjen e tij të kërkuar.

Megjithatë, kostot e trajnimit prej \$300,000 duhet të shpenzohen në fitim ose humbje pasi ato nuk konsiderohen si kosto direkte.

Po kështu kostot e reklamimit prej 1 milion dollarësh të produktit të ri (Produkti C) të prodhuar nga makina e re duhet gjithashtu të trajtohen si shpenzim. SNK 16 ndalon në mënyrë specifike kapitalizimin e kostove të prezantimit të një produkti ose shërbimi të ri.

Sipas SNK 16, amortizimi duhet të fillojë kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, dmth. kur është në vendndodhjen dhe gjendjen e nevojshme që ai të jetë në gjendje të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Prandaj, amortizimi në makinën e re duhet të fillojë më 31 tetor 2022 kur të ketë përfunduar testimi i funksionalitetit dhe të fillojë prodhimi tregtar.

## Ushtrimi 9

Shoqëria Mëmë B i jep hua filialeve të saj pa interes. Më 1 janar 2018, Shoqëria Mëmë B dha një hua prej 1 milion Lekë për filialin C me kushtet e mëposhtme: 1 milion Lekë e ripagueshme në tre vjet, në dhjetor 2020 me 0% interes. Bazuar në parashikimet aktuale të fluksit të parave, filiali C pritet të paguajë deri në dhjetor

2020. Norma e tregut për instrumenta të ngjashëm është 15%. Shoqëria përllëgarit se vlera aktuale e 1 milion Lekë në tre vjet e aktualizuar me normën e interesit të tregut prej 15% është 658,000 Lekë.

**Kërkohet:** Sipas SNRF 9 “Instrumentet financiare” tregoni trajtimin kontabel duke pasqyruar veprimet kreditore dhe debitore në njohjen fillestare për Shoqërinë Meme dhe për Filialin C? Argumentoni përgjigjen tuaj.

**Zgjidhje:**

Për të përmbushur testin VPPI, fluksi kontraktual monetarë prej 1 milion Lekë në tre vjet duhet të përfaqësojë pagesa të principalit (duke qenë vlera fillestare e drejtë) dhe interesit (interesi i përllëgaritur duke përdorur metodën e Normës së Interesit Efektiv (NIE). Vlera fillestare e drejtë do të jetë shuma e njohur në përputhje me SNRF 9 në njohjen fillestare që zakonisht është e barabartë me çmimin e transaksionit. Në këtë rast vlera fillestare e drejtë matet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme monetare të aktualizuara me një normë të përshtatshme interesi tregu për një hua të ngjashme në datën e njohjes fillestare.

Trajtimi kontabël i sugjeruar për Shoqërinë Meme B:

Në njohjen fillestare, Shoqëria Meme B njeh huanë si vijon:

Debi - Kredi të arkëtueshme : 658,000 Lekë  
Debi - Investimi në filiale : \*342,000 Lekë (\*1 milion LEKE – 658,000 LEKE).  
Kredi - Mjete Monetare : 1 milion Lekë

Për Filialin C, çregjistrimi kontabël është shumë i ngjashëm:

Debi - Mjete Monetare : 1 milion LEKË  
Kredi - Kredi të pagueshme : 658,000 LEKË  
Kredi - Kapitali - kontributet e kapitalit : 342,000 LEKË

## Ushtrimi 10

Omega është një njësi ekonomike që përgatit pasqyrat financiare në datë 30 Shtator çdo vit. Më 1 korrik 2022, drejtimi vendosi të ndërpres prodhimin në një nga divizionet e kompanisë. Ky vendim është shpallur publikisht më 31 Korrik 2022. Aktivitetet e divizionit u reduktuan gradualisht nga data 1 Tetor 2022 dhe mbyllja pritët të përfundojë deri më 31 Mars 2023. Më 31 korrik 2022, drejtimi përgatiti vlerësimet e mëposhtme të pasojave financiare të mbylljes si më poshtë:

- (i) Kostot e kompensimit të punonjësve për ndërprerjen e shërbimeve të tyre fillimisht u vlerësuan në 2 milion lekë. Shpenzimet e mëtejshme do të jenë 800,000 lekë, të nevojshme për të ritrajnuar punonjësit që do të preken nga mbyllja, por që do të mbeten punonjës të Omega në divizione të tjera. Ky rikualifikim do të fillojë në fillim të Janarit 2023. Sipas vlerësimeve më të fundit, kostot e kompensimit të punonjësve për ndërprerjen e shërbimeve të tyre do të jenë 1.9 milionë lekë, me kosto ritrajnimit prej 850,000 lekë.
- (ii) Impiantet dhe pajisjet që kanë një vlerë kontabël të pritshme në 30 Shtator 2022 prej 8 milion lekë do të kenë një vlerë të rikuperueshme 1,5 milion lekë. Këto vlerësime mbeten të vlefshme.
- (iii) Divizioni ka një kontratë aktive për të furnizuar një klient për tre vitet e ardhshme me një çmim të paracaktuar. Do të jetë e nevojshme për të paguar një kompensim prej 600,000 lekë për këtë klient. Kompensimi i paguar më 30 Nëntor 2022, ishte 550,000 lekë.

- (iv) Divizioni do të ketë humbje operative prej 300,000 lekë në muaj, në tre muajt e fundit 2022 dhe 200,000 lekë në muaj në tre muajt e parë të 2023. Ky vlerësim rezultoi i saktë për muajin Tetor dhe Nëntor 2022.

**Kërkohet:** Llogarisni dhe argumentoni vlerat që do të përfshihen në Pasqyrën financiare të fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin që mbyllet më datë 30 Shtator 2022. Kur informacioni i paraqitur më lartë nuk ka efekt në pasqyrën e mësipërme ju duhet të shpjegoni pse?

Zgjidhje:

SKK 6 Provizionet, pasivet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara thekson se një provizion ristrukturimi mund të krijohet kur njësi ekonomike:

- Ka një plan formal të detajuar ku janë identifikuar ristrukturimet që do bëhen
- Plani është bërë publik duke ngritur pritshmëri të vlefshme tek ata që preken nga ristrukturimi
- Plani do të realizohet brenda 12 muajve nga data e pasqyrave financiare

Të treja kushtet e mësipërme plotësohen në rastin e Omega, prandaj duhet të krijohet një provizion.

(i) Kostot e kompensimit të punonjësve për ndërprerjen e shërbimeve të tyre përfshihen në vlerën e këtij provizionit pasi ato janë të shkaktuara nga ristrukturimi dhe nuk lidhen me aktivitetet e vazhdueshme të Omega. SKK 6 kërkon që provizionet të maten me vlerësimin më të mirë dhe besueshëm të shpenzimeve të kërkuara, në rastin tone kjo vlerë është 1.9 milion lekë. Kjo ngjarje pra informacion me aktual në lidhjen me koston e këtij kompensimi klasifikohet si një ngjarje rregulluese në përputhje me SNK 10 Ngjarjet pas Dates së Bilancit, prandaj, fitimi zvogëlohet me 1.9 milion dollarë. 1.5p

850,000 lekët e kërkuara për rikualifikimin e punonjësve nuk do të përfshihen në vlerën e provizionit dhe nuk do të ndikojnë në fitimin e periudhes, pasi lidhen me aktivitetet e vazhdueshme të Omega-s.0.5p

(ii) Edhe pse nuk janë pjesë e ristrukturimit, impiantet dhe pajisjet me një vlerë kontabël prej 8 milionë lekë por me një vlerë të rikuperueshme prej 1,5 milionë lekë janë dukshëm të zhvlerësuara. SKK 5 kërkon që ato të riparaqiten me vlerën e rikuperueshme prej 1.5 milion lekë, duke rezultuar në njohjen e një humbjeje nga zhvlerësimi prej 6.5 milion lekë në fitim dhe humbje.

(iii) Pasqyra e fitimit ose humbjes do të njohë një shpenzim prej \$550,000. Në përputhje me SNK 10, kjo do të klasifikohet si një ngjarje rregulluese. Meqënëse kjo është një pasojë direkte e ristrukturimit atëherë do të përfshihet në vlerën e tij.

(iv) SKK 6 nuk lejon që një provizion të përfshijë shuma në lidhje me humbjet e ardhshme operative, pasi ato lidhen me aktivitetet e vazhdueshme të njësisë ekonomike. Nuk do të njihet asnjë shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes në lidhje me këto humbje për vitin e mbyllur më 30 shtator 2022. Provizionet duhet të njihen vetëm për ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën, ndërsa këto humbje të pritshme ndodhin në të ardhmen.